



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 mars 2015  
Nr. ref.: RK 781/15

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin nr. KI186/14**

Parashtrues

**Sahit Kurti**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,  
Rev. nr. 153/2014, të 17 qershorit 2014**

## **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Sahit Kurti (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) nga Mitrovica, i cili përfaqësohet nga Shoqëria e Avokatëve „Sejdiu & Qerkini“ SH.P.K. nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kérkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 153/2014, të 17 qershorit 2014. Me këtë aktvendim është refuzuar si i pabazuar revizioni i parashtruesit të kérkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit CA. nr. 3986/2012 të 16 shtatorit 2013. Aktvendimi i kontestuar i ishte dorëzuar parashtruesit të kérkesës më 15 tetor 2014.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është kérkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kérkesës konsideron se gjykatat e rregullta kanë llogaritur gabimisht afatet kohore për parashtrim të padisë, dhe në këtë mënyrë janë shkelur nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kérkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 31 dhjetor 2014, parashtruesi i kérkesës dorëzoi kérkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
6. Më 13 janar 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI186/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI186/14, caktoi Kolegjin shqyrties, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
7. Më 23 janar 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kérkesës.
8. Më 6 shkurt 2015, Kolegji shqyrties e shqyrtoi raportin e gjyqtarit rapportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kérkesës.

## **Përbledhja e fakteve**

9. Parashtruesi i kérkesës ka qenë në marrëdhënie pune si oficer policie në Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK) prej 24 dhjetorit 2000 deri më 4 gusht 2005, kur marrëdhënia e tij e punës ishte ndërprerë me Vendimin Ref. 459 - KPS – 2004, të 4 gushtit 2005.
10. Kundër këtij vendimi, parashtruesi i kérkesës parashtroi ankesë në Komisionin e ankesave në SHPK, e cila ishte refuzuar si i pabazuar.

11. Më 6 tetor 2005, parashtruesi i kërkesës ishte njoftuar për vendimin e Komisionit për ankesa, përmes shkresës së SHPK-së, e cila i ishte dorëzuar atij më 14 tetor 2005.
12. Më 25 nëntor 2005, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, kundër vendimit të Komisionit për ankesa të SHPK-së.
13. Më 14 mars 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktvendimin C1. nr. 264/07, të 14 marsit 2012, i cili ishte bazuar në nenin 83 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës hodhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës si të palejueshme, pasi ajo ishte paraqitur pas afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh.
14. Më 20 korrik 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë.
15. Më 16 shtator 2013, Gjykata e Apelit në Prishtinë, me Aktvendimin Ca. nr. 3986/2012, refuzoi ankesën si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C1. nr. 264/07, të 14 marsit 2012. Arsyetimi ishte se „*gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se paditësi padinë e ka paraqitur pas afatit të paraparë ligjor, me ç'rast ka humbur të drejtën të kërkojë mbrojtje gjyqësore nga marrëdhënia e punës*”.
16. Më 11 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ca. nr. 3986/2012, të 16 shtatorit 2013.
17. Më 17 qershor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Rev. nr. 153/2014 e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion, me arsyetimin si në vijim:

*“... Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitën e nenit 83 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës, për arsy se ky afat është prekluziv dhe pas skadimit të tij punëtori e humbë të drejtën e mbrojtjes gjyqësore, prandaj, padia e paraqitur pas këtij afati doemos duhet të hidhet poshtë si e pasafatshme, andaj gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi se thëniet e cekura në revizion janë të pabazuara. Në revizion nuk është cekur asnjë rrethanë e cila do ta vente në dyshim ligjshmërinë e aktvendimit të kundërshtuar”.*

### Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës konsideron se për shkak të llogaritjes së gabueshme të afateve kohore nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.
19. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata si në vijim:

- “I. Që të shpallë se Kërkesa e Parashtruesit të Kérkesës është e pranueshme;
- II. tē konstaton se e drejta kushtetuese e parashtruesit të kérkesës pér një gjykim tē drejtë dhe tē paanshëm e garantuar me nenin 31 tē Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 6 tē Konventës Europiane pér të Drejtat dhe Liritë e Njeriut e ndërlidhur edhe me tē drejtën pér mbrojtje gjyqësore tē tē drejtave dhe tē drejtën pér mjete efektive juridike e garantuar me nenin 54 tē Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 13 tē Konventës Europiane pér të Drejtat dhe Liritë e Njeriut është shkelur nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës përmes Aktvendimit Rev. nr. 153/2014;
- III. tē shpallë tē pavlefshëm Aktvendimin Rev. nr. 153/2014 tē Gjykatës Supreme, tē datës 17.06.2014
- IV. tē përcaktojë dhe vendosë qfarëdo mase tjetër juridike që Gjykata Kushtetuese e vlerëson si tē bazuar në Kushtetutë dhe në Ligj dhe e cila është e arsyeshme pér rastin në fjalë“.

### **Pranueshmëria e kérkesës**

20. Gjykata do tē shqyrtojë nëse parashtruesi i kérkesës i ka përbushur kriteret e pranueshmërisë tē përcaktuara me Kushtetutë, dhe tē specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore tē punës.

21. Gjykata i referohet nenit 113.7 tē Kushtetutës, i cili parasheh:

*“Individët janë tē autorizuar tē ngrenë shkeljet nga autoritetet publike tē tē drejtave dhe lirive tē tyre individuale, tē garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi tē kenë shteruar tē gjitha mjetet juridike tē përcaktuara me ligj”.*

22. Gjykata gjithashtu thekson nenin 48 tē Ligjit, i cili thotë:

*“Parashtruesi i kérkesës ka pér detyrë që në kérkesën e tij tē qartësoj saktësish se cilat tē drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik tē cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

23. Përveç kësaj, Gjykata përkujton rregullin 36 (2) (b) tē Rregullores së punës, i cili thotë:

*„(2) Gjykata do tē deklarojë një kérkesë si qartazi tē pabazuar, nëse bindet se:*

*...*

*(b) faktet e paraqitura në asnje mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin pér shkeljen e një tē drejte kushtetuese“.*

24. Duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kérkesës në lidhje me aplikimin e gabuar tē së drejtës procedurale dhe materiale nga ana e gjykatave tē rregullta, Gjykata ripërsërit se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, tē veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave tē rregullta tē interpretojnë dhe tē zbatojnë rregullat përkatëse juridike. (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ,

Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

25. Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 153/2014, i 17 qershorit 2014, jep përgjigje të arsyetuar në të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës, lidhur me mënyrën e llogaritjes së afateve si dhe arsyet e aplikimit të rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale.
26. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kryesisht nuk është i kënaqur me kualifikimin juridik të fakteve dhe të ligjit të zbatuar nga gjykatat e rregullta. Kualifikimi juridik i fakteve dhe ligji i zbatuar janë çështje të ligjshmërisë.
27. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese (Shih, *Vanek kundër Republikës Sllovake*, vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005).
28. Edhe pse parashtruesi i kërkesës pretendon se të drejtat e tij janë shkelur me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta, ai nuk ka treguar se si këto vendime kanë shkelur të drejtat e tij kushtetuese.
29. Gjykata në vazhdim thekson se fakti i thjeshtë, se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës në rastin e tij nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e Kushtetutës (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykim i GJEDNJ-së, kërkesa nr. 5503/02, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).
30. Parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që të paraqes rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit si të pasaktë, para Gjykatës Themelore në Prishtinë, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës.
31. Pas shqyrimit të procedurës në tërësi, Gjykata nuk gjen se procedurat përkatëse, në ndonjë mënyrë, janë të padrejta apo arbitrale (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
32. Gjykata konsideron se nuk janë plotësuar kushtet për pranueshmëri. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të tregojë dhe të mbështesë me prova se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese.
33. Nga kjo rrjedh se kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 6 shkurt 2015, njëzëri

## VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

Snezhana Botusharova

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani

